



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË

V E N D I M

Nr. 25, datë 09. 10. 2012

PËR

“NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK NR. 3, DATË
05.02.2007 PËR “SISTEMIN E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE NË QYTETIN
E TIRANËS (I NDRYSHUAR)””

Në mbështetje të nenit 7, pika 2, nenit 8, pika III/”b”, nenit 16, nenit 32, shkronja “f” të ligjit nr.8652, datë 31.07.2000 për “Organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” (i ndryshuar); nenit 33 të ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e taksave vendore” (i ndryshuar); nenit 128 të ligjit nr.8485, datë 12.05.1999 “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë (i ndryshuar) dhe vendimit të Këshillit Bashkiak nr.3, datë 05.02.2007 për “Sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Tiranës” (i ndryshuar); me propozim të Kryetarit të Bashkisë Tiranë, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I

1. Në vendimin e Këshillit Bashkiak nr.3, datë 05.02.2007 për “Sistemin e Taksave dhe Tarifave Vendore në Qytetin e Tiranës” (i ndryshuar), bëhet shtesa si më poshtë:

1.1. Në ndarjen **Taksat Vendore**, pas paragrafit të fundit të shkronjës “f”, shtohet shkronja “g” **Taksa e përkohshme për lojërat e fatit**, me përmbajtje si më poshtë:

“Taksës së përkohshme të lojërave të fatit i nënshtrohen të gjithë personat fizikë ose juridikë, vendas ose të huaj të licensuar për kryerjen e aktivitetit për lojra fati (sipas ligjit nr.10033, datë 11.12.2008 për “Lojërat e fatit”) brenda territorit të Bashkisë së Tiranës.

Taksa e përkohshme e lojërave të fatit aplikohet për çdo sallë ku zhvillon veprimtarinë organizatori.

Niveli i taksës së përkohshme të lojërave të fatit aplikohet i diferencuar sipas ndarjes zonale të hartës së qytetit të Tiranës për efekt të zbatimit të taksave vendore si më poshtë:

Për Kazinot dhe Kazinot elektronike, niveli i taksës deri në datën 30.06.2013 është si më poshtë:

- Për subjektet e zonës A, niveli i taksës është 1.000 lekë/m²;*
- Për subjektet e zonës B, niveli i taksës është 700 lekë/m²;*

- Për subjektet e zonës C, niveli i taksës është 500 lekë/m²;

Për Kazinot dhe Kazinot elektronike, niveli i taksës pas datës 30.06.2013 është si më poshtë:

- Për subjektet e zonës A, niveli i taksës është 10.000 lekë/m²;
- Për subjektet e zonës B, niveli i taksës është 7.000 lekë/m²;
- Për subjektet e zonës C, niveli i taksës është 5.000 lekë/m²;

Të gjitha subjektet që do të ushtrorjnë aktivitetin e tyre në territorin e Uzinës së Ndërrimit të Automjeteve (“UPNA”, ish –uzina e Autotraktoreve – Shkozë), nuk do të aplikohet taksa e përkohshme e lojrave të fatit.

Për lojërat e tjera të fatit si: Baste sportive, Baste për gara në pistë, Lotari kombëtare, Bingo tradicionale dhe Bingo televizive, niveli i taksës është 5000 lekë/muaj;

Taksa e përkohshme e lojërave të fatit është taksë mujore dhe paguhet brenda datës 10 të muajit pasardhës për llogari të muajit të mëparshëm. Në rast të mos shlyerjes së detyrimit në kohë, zbatohen masat administrative konform ligjit 9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e taksave vendore”(i ndryshuar) dhe ligjit nr.9920, datë 19.5.2008 për “Procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar).

Subjektet e kategorisë së lojërave të fatit Kazino dhe Kazino Elektronike që zhvendosin aktivitetin e tyre në territorin e Uzinës së Ndërrimit të Automjeteve (“UPNA”, ish –uzina e Autotraktoreve – Shkozë), përfitojnë rimbursim të pagesave të kryera të kësaj takse, si më poshtë:

- Për zhvendosjen brenda datës 30 Qershor 2013, rimbursohen në vlerën 100% të pagesës së kryer nga hyrja në fuqi e kësaj takse;
- Për zhvendosjen brenda datës 30 Shtator 2013, rimbursohen në vlerën 50% të pagesës së kryer nga hyrja në fuqi e kësaj takse;

Struktura e ngarkuar për mbledhjen e Taksës së Përkohshme për lojërat e fatit është Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore”.

2. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore dhe drejtoria e Planifikimit Strategjik për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi 01.01.2013.

K R Y E T A R I

Niazi KOSOVRASTI